




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit i mbledhjes së parë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 30. 1. 2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

Munguan: Arton Brahimi, Triera Kasumi Berisha, Faton Marolli, Elmira Nikçi.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Betim Abdullahu - zyrtar për komunitete në ZKKK-ës, Qefsere B. Veseli - zyrtare për komunitete në ZKKK-ës, Fisnik Dida – përfaqësues i OSCE-së, Arianita Beqa – Rraci, përfaqësuese e UNMIK-ut.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ngritura e cilësisë së punës e Komitetit për Komunitete në nivel më të lartë dhe përgjegjësi më e madhe e të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete;
3. Analiza e punës së Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2023;
4. Shqyrtimi i kërkesave për ndihmë për të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë për kremin e festave kombëtare, a) Pasqyrë e aktiviteteve të planifikuara të punës së Komitetit për Komunitete sipas planit vjetor të punës për vitin 2024);
5. Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave çdo muaj sipas prioriteteve për vitin 2024;
6. Raporti i ZKKK-ës për muajin dhjetor 2023;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së ZKKK-ës për vitin 2023;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
9. Të ndryshme.

Njëzéri u miratua rendi i ditës.

Faqe 1 nga 7

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së.

Njëzëri u miratua ekstrakti të procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ngritja e cilësisë së punës e Komitetit për Komunitete në nivel më të lartë dhe përgjegjësi më e madhe e të gjithë anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Pika e tretë

Analiza e punës së Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2023.

Mirsada Behluli: – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se siç e dini se raportin vjetor të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 e kemi dorëzuar përmes të cilit ju kemi informuar lidhur me aktivitetet dhe punën e komitetit, raport i cili edhe është pranuar. Ajo në vazhdim ceku disa prej punëve duke u nisur prej dorëzimit të raporteve në ZKKK-ës, bashkëpunimi me drejtore të kompetente të komunës, ndihma e komuniteteve joshumicë me pako ushqimore, higjenike, me dru zjarri, bashkëpunimi me Zyrën për komunitete pranë kryeministrat, vizita e shkollave ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve joshumicë, interesimi për projektet e investimeve kapitale, asfaltimi i rrugës prej 200 metrave në Bërnicë të Poshtme, rregullimi i ujësjellësit në fshatin Slivovë etj.

Pika e katërt

Shqyrtimi i kërkesave për ndihmë për të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë për kremin e festave kombëtare, a) Pasqyrë e aktiviteteve të planifikuara të punës së Komitetit për Komunitete sipas planit vjetor të punës për vitin 2024.

Betim Abdullahu: - sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se a mundem nëse bën te kremin i ditëve të festave ose ditëve të flamurit, prej komuniteteve është viti i dytë apo i tretë që ne nuk kemi marrë mbështetje nga kabineti edhe pse i kemi dorëzuar kërkesat në kabinet. Ai në vazhdim tha se meqë më 15 shkurt është Dita e flamurit e komunitetit ashkali, do të ishte mirë që ju si komitet dhe ne si ZKKK t'i bëjmë kërkesë kabinetit për një mbështetje minimale p.sh. secili komunitet që e ka festën, të mbledhemë dhe të paktën një drekë ose një festë të vogël ta mbajmë.

Mirsada Behluli: - duke iu drejtuar z. Abdullahu shtroi pyetje se kujt duhet t'i drejtohet me kërkesë.

Betim Abdullahu: - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se duhet t'i drejtohet Kabinetit të Kryetarit dhe te Drejtoria e Kulturës.

Nenad Miladinovic: - tha se pajtohet me propozimin që dha Betimi që është propozim shumë i mirë, që ne të merremi vesh dhe të kemi një paraqitje të përbashkët d.m.th. t'i drejtohemë me kërkesë Kabinetit të Kryetarit dhe Drejtorisë së Kulturës dhe të jetë shuma e caktuar për të gjitha komunitetet d.m.th që të jetë shuma e përbashkët e njëjtë për të gjithë komunitetet, pra të jetë e barabartë dhe jo të ndryshojë. Nuk e di deri tani se cilën shumë e kanë pranuar, d.m.th të kerkohet një shumë e njëjtë për të gjithë të jetë një drekë apo diçka ku mund të shoqërohemë pak, nuk ka rëndësi të jetë diçka e madhe. Në fund tha të merremi vesh të jetë një propozim apo marrëveshje të cilën ne e arrijmë ta kemi dhe atëherë të drejtohet si marrëveshje që ne së bashku e kemi arritur dhe për shumën ne mund të merremi vesh këtu sa na duhet për të gjithë.

Betim Abdullahu: - tha se do të ishte mirë me i marrë të gjitha datat e festave për secilin komunitet, mirë e tha Nenadi të dakordohemi për një çmim, a ka me qenë 1000, a 2000 apo 500, që të kemi mundësi ne me i bë presion kabinetit, pastaj le të vendos kryetari, apo ia jep Drejtorisë së Kulturës për të na financuar neve, apo me finançat direkt nga kabineti, është çështje e tyre e brendshme.

Mirsada Behluli: - sa i përket datave të festave të komuniteteve joshumicë tha se Dita e Ashkalinjve - është me 15 shkurt, Dita e Romëve - 8 prill, Dita e Turqve - 23 prill, Dita e Serbëve - 5 maj, Goranët - 6 maj dhe Boshnjakët - 28 shtator të vitit 2024. Ajo në vazhdim tha se unë kam pasur një ide në kokën time, ndoshta kjo do të ishte shumë më e lehtë, vitin e kaluar kam bërë projektin me komunitetin organizativ, kjo ka qenë shumë e vështirë të bëhet sipas këtij projekti dhe vlera ka qenë 1,500.00 euro, për sallën në Pallatin e Rinisë dhe duhet të paguhet ajo sallë dhe pastaj e dyta duhet që t'i ftojmë disa nga figurat akademike siç është një person nga Bosnja Ferid Mujiç, mirëpo kjo ka qenë e pamundur të realizohet, unë kur i kam thënë duhet të paguhen 1,500.00 euro ata kanë thënë se është vlerë shumë e vogël dhe kanë refuzuar të marrin pjesë. Mirëpo në nivelin qendror e tërë kjo është realizuar shumë mirë, i tërë ky projekt është realizuar nga niveli qendror dhe ka shkuar shumë mirë, unë e kam pasur në kokën time një propozim, qysh kishte mundur të organizohet diçka e tillë, në mënyrë institucionale, p.sh. me 15 shkurt, këtu ta organizojmë një takim për ditën nationale të ashkalinjve, të organizohet në mënyrë më të mirë institucionale, ku do të ftohet kryetari ose përfaqësues të komunës, të cilët na përfaqësojnë dhe të jemi këtu në këtë sallë, në këtë tavolinë, të organizojmë ndoshta prej ashkalinjve, të ftohen disa njerëz eminentë prej tyre, të ftohen kamerat, mediat dhe kështu do të jetë në mënyrën më të mirë zyrtare dhe institucionale dhe do të ketë shpenzime shumë të vogla.

Nenad Miladinoviç: - tha se unë menjëherë po deklarohem se nuk jam për një propozim të tillë dhe arsyen do ua tregoj menjëherë. Meqenëse një takim i tillë nuk do të kishte asnë kuptim të ishte në mbledhjen e rregullt të Komitetit për Komunitete sepse mbledhja e rregullt duhet të jetë mbledhje e rregullt e Komitetit të Komuniteteve.

Mirsada Behluli: - nuk kemi nevojë në tërë mbledhjen, mundemi edhe një ditë tjetër ose mundemi një pjesë të mbledhjes gjysmë ore, pastaj të vazhdojmë me mbledhjen, d.m.th. të kretohet kjo festë në ditën nationale të tyre, të mbahet mbledhje dhe më pas të vazhdohet mbledhja, si mendoni ju?

Betim Abdullahu: - tha se ideja nuk është e keqe si edhe pajtohem me Nenadin se nuk e kisha kushtëuar, mbledhjen e rregullt me kremltim të festës, ne mundemi me u mbledh në çdo ditë festë që janë, me i ftuar edhe përfaqësuesit tjerë. Ai në vazhdim tha se do të ishte mirë që kur t'i bëhet kërkesa kabinetit është mirë t'i bëhet edhe zyrës qendrore ndoshta na mbulon këto shpenzime nëse komuna nuk i mbulon.

Mirsada Behluli: - tha se pra mbetet të mendojmë dhe të organizojmë, si dhe unë mundem ta paraqesë një kërkesë kryetarit dhe Drejtorisë së Kulturës, me këto opsione dhe pastaj ata të përgjigjen dhe atëherë juve do t'ju informoj.

Oktay Kurtesh: - duke iu drejtuar znj. Behluli shtroi pyetje lidhur me kërkesën që do t'i bëhet kryetarit, në ç'rast tha se vetëm dua të di se a po dëshiron me qenë vetëm në letër apo për çka se ka 1 vit nuk e kemi parë kryetarin. Ai në vazhdim tha se ndoshta për komunitetin turk nuk është bërë asgjë fare.

Betim Abdullahu: - a mundemi nëse bën te kremlimi i ditëve të festave ose ditëve të flamurit, prej komuniteteve është viti i dytë apo i tretë që ne nuk kemi marrë mbështetje nga kabineti. Pas ca diskutimesh, propozimesh dhe sugjerimesh u aprovua pasqyra e aktiviteteve të planifikuara të punës së Komitetit për Komunitete sipas vjetor të punës për vitin 2024.

Pika e pestë

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave çdo muaj sipas prioriteteve për vitin 2024.

Mirsada Behluli: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se disa prej kërkesave që kam pasur më janë miratuar nga kryetari.

Betim Abdullahu: - sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se nuk kemi pasur ankesa tjera përvèç druve të zjarrit, për këtë arsy e thash që nga ky moment me kërkuar prej drejtorive dhe kabinetit në një farë forme me iu bërë presion, që ma pas mundësi që ky projekt me kaluar edhe kur të del buxheti vjetor për këtë arsy është mirë të dimë ne se sa familje i kemi dhe me i propozuar kuvendit që me i votuar, si buxhet pavarësisht se në cilën drejtori e fusin për subvencion, me qenë buxhet i miratuar nga Kuvendi komunal, Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, por me pas buxhet që pavarësisht ata a kanë buxhet për subvencionet e tjera si drejtori.

Mirsada Behluli: - shtroi pyetje se a dihet data se kur votohet buxheti?

Betim Abdullahu: - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se buxheti është votuar për vitin 2024 dhe zakonisht votohet në shtator, por në rast se ka rishikim të buxhetit mund me pas në qershori ose korrik dhe nëse bëhet rishikimi mund të alokohen mjetet, p.sh. për një subvencion të caktuar, nëse bën qeveria rishikim të buxhetit bëjnë edhe nivelet lokale.

Kimeta Shok: - shtroi pyetje a ekziston kjo ndihma njëherë për të sëmurët?

Betim Abdullahu: - po janë duke aplikuar, kanë filluar aplikimet nga 3 janari në Qendrën për shërbime me qytetarë, aplikimi realisht zgjat gjatë gjithë vitit. Unë e kam një informatë se vitin e kaluar janë mbuluar ato raste deri kur kanë pasur buxhet p.sh. i kanë pasur 400,000.00 euro buxhet, por kërkesat kanë qenë 2700-2800 dhe janë mbuluar deri te ajo shumë, ndërsa të tjerat kanë mbetur. Këtë vit kanë filluar me i filtruar dhe përparsinë kryesore e kanë personat me kancer dhe kur të përfundohen ata persona mbulohen por edhe shuma e përkrahjes dallon, shuma për ata me kancer dhe sëmundjet tjera ndryshon. Kështu që nëse keni raste është mirë me iu thënë që të aplikojnë. Nuk duhen shumë dokumente: raportin e mjekut që e dëshmon sëmundjen që e ka, një vërtetim nga bashkësia lokale të vendbanimit, një letërkonfirmim nga banka dhe letërnjoftimin kopje.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-ës për muajin dhjetor 2023.

Betim Abdullahu: - tha se nuk isha ndalur shumë tek raporti i vitit 2023, çka është bërë në dhjetor në ditët e aktivizimit prej Departamentit për barazi gjinore, në ç'rast i kanë mbajtur fushatë komunitetit Klaudia me Premtimen dhe si pikë kryesore ishte shpërndarja e druve të zjarrit dhe dhuratat për fëmijët e komuniteteve, kurse tash puna me integrim dhe riintegrin nuk na hyn neve në punë si komunitet.

Mirsada Behluli: a po pajtoheni me këtë raport të ZKKK-së, a ka dikush ndonjë vërejtje, nëse nuk ka e miratojmë.

Nenad Miladinoviç:- tha se unë do të kthehesha pak në analizën e raportit të komuniteteve, ku dua të theksoj, disa drejtori me të cilat kemi pasur bashkëpunim dhe me disa drejtori për fat të keq nuk kemi pasur bashkëpunim, por kërkohet edhe mundi jonë që të kemi bashkëpunim sa më të mirë. Ai në vazhdim tha se

dua të theksoj Drejtorinë për Investime Kapitale, me të cilën kemi pasur raporte shumë të mira dhe bashkëpunim shumë të mirë. Nëse shikojmë dhe pyesim pse disa projekte janë realizuar e disa jo kjo është forma e procedurës ligjërisht, por kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë dhe vullnet shumë të mirë. Ndërsa sa i përket Drejtorisë së Mirëqenies Sociale edhe me këtë drejtori gjithmonë kemi pasur bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë, por për vitin 2023, kemi pasur vërejtje për shkak tonin dhe mendoj se bashkëpunimi jonë duhet të përmirësohet, është fjala për ndihmat e njëherëshme dhe sa i përket materialit për ngrohje druzjarri, të përfitojmë sa më shumë për të gjitha komunitetet. Po ashtu më duhet të ceku edhe një drejtori e cila është shumë me rëndësi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, lirisht mund të them se bashkëpunimi nuk ka qenë i kënaqshëm. Do të provojmë përmes kabinetit të kryetarit, përmes kryesuesit të kuvendit, duke i dërguar kritika për drejtorin e shërbimeve publike dhe bashkëpunimi jonë të përmirësohet me ta, sidomos në vendet rurale, kemi shumë probleme sidomos me hedhjen e mbeturinave, deponimeve ilegale dhe tjetra shqetësimi i banorëve për qentë endacakë edhe më herët i kemi pasur këto probleme, por jo kaq të shfaqura siç janë tash dhe për këtë apeloj se janë disa vërejtje për vitin 2023 dhe mendoj se të gjitha këto do të shkojnë më mirë në vitin 2024.

Mirsada Behluli: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se në takimet e mëhershme jemi pajtuar, për të gjitha problemet tona si ato të romëve, turqve, serbëve t'i drejtojmë me e-mail ose kërkesë në sportel të komunës, për të mos mbaruar në një sirtar dhe shpresojmë në përkrahje dhe ndihmë Zyrës për komunitetet të na ndihmojë kur duhet t'i drejtohem drejtorisë së caktuar, të na caktioni takimin, të na përkrahni aty dhe të na hapni rrugën për të shkuar te një drejtori përkatëse dhe deri te kryetari, zëvendëskryetari, që ne me efektivitet të kryejmë, kërkesat dhe problemet tona, sepse kemi qenë në situatë të kërkojmë ndihmë dhe askush nuk ka mundur të na caktojë një takim te kryetari apo te zëvendësi.

Betim Abdullahu: - duke iu drejtuar të pranishmëve tha se nëse keni projekte ose keni ndonjë kërkesë për projekte, për këtë vit për investime kapitale, për shërbime publike, kishte me qenë mirë me i fut në mbledhjen e radhës edhe të bëni kërkesën së bashku me neve që me pas mundësi me i pas përpara dhe me pa se deri ku po arrijmë.

Mirsada Behluli: - a keni ndonjë projekt për investime kapitale, meqenëse numri i komunitetit tuaj është shumë i madh, a keni ndonjë projekt?.

Nenad Miladinović: - sa i përket projekteve tha se kam një projekt për investimet kapitale, që nuk kanë të bëjnë vetëm me komunitetin serb, por me të gjitha komunitetet sa i përket shpenzimeve kapitale ku hyn ndërtimi i rrugëve, kanalizimi, ujësjellësi, ndonjë park i vogël, të gjitha të tjerat kalojnë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Oktay Kurtesh: - sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se sa i përket sigurisë nuk kemi probleme vetëm se problem kemi me asfaltim, me ndriçim në rrugën "Bajram Kelmendi", me mbeturina, si dhe me qentë endacakë, pastaj është rruga "Emin Duraku", te shkolla "Elena Gjika", që është bërë rrugë, rruga është mbyllur për trafik, për ata të lagjes si shesh ose për fëmijë që mos të ketë vitura, është mbyllur rruga dhe sonte faktikisht nëse shkonit e shihni që është errësirë.

Betimi Abdullahu: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se edhe pse nuk është në sektorin tonë, por informatat që i kam për komplet vitin 2023 janë, është e vërtetë se problem i krejt kryeqytetit ka qenë puna e qenve endacakë, nuk kemi pse me e diskutuar nuk është duke funksionuar pavarësisht premtiveve që i ka bërë kryetari edhe drejtoria nuk është ka funksionon. Ndërsa sa i përket çështjes së mbeturinave pritet me u bë zgjidhja shumë shpejt, Ndërmarrja Banesore është duke i sjell kontejnerat shumë shpejt. 3000 kontejnerë veç janë duke u rregulluar ndihmë prej Ndërmarrjes Banesore, pa pagesë për drejtori, kurse procedurat për blerjen

e kamionëve janë në përfundim e sipër janë duke u blerë disa kamionë të rinj në vitin 2024, kurse sa i përket qenve ka me pas prapë Oktay, ndërkaq rruga që e përmende nëse nuk vonohen procedurat në prill pritet të fillojë nënkalim prej Siriusit ose Fakultetit Juridik, ose Ministrisë së Arsimit deri tek rrëthi këtu nën objektin e komunës dhe do të lidhet Prishtina e vjetër me këtë pjesën e trekëndëshit dhe do të bëhet shesh deri te gjimnazi "Sami Frashëri".

Kimeta Shok: - duke iu drejtuar z. Abdullahu tha se sa i përket mbeturinave, e gjithë kjo të cilën e keni paraqitur, e kemi dëgjuar vitin e kaluar dhe 1 vit asgjë nuk është bërë sa i përket mbeturinave. Tash është dimri, mirëpo verës kundërmon shumë dhe është problemi më i madh në qytet, është e kot këto ndërtimë kur ka mbeturina gjithandej.

Betim Abdullahu: - unë e di për ata të thash se ka qenë problemi më i madh i kryeqytetit për vitin 2023, por Ndërmarrja "Pastrimi", d.m.th. qeverisja e re e ka trashëguar me 3 kamionë, unë e di se kanë marrë kamionë edhe nga Podujeva edhe nga Obiliqi për t'i asistuar për t'u munduar, për të ndaluar pak problemin.

Kimeta Shok: - qytetarët paguajnë çdo muaj.

Mirsada Behluli: - tha se është marrë një shumë e mjeteve 1 milion e diçka që të blejnë kamionë, kontejnerë dhe të shohim se a do të shkojnë gjérat kështu siç është thënë, sepse me të vërtetë shumë ndërtim i madh në Kosovë, mirëpo infrastruktura dhe realizimi apo largimi i këtyre mbeturinave do të dukej bukur po të ishte në nivel më të lartë. Të mbesim me shpresë se këto premtimet se ky problem në të ardhmen të realizohet. Unë do t'i dërgoj një e-mail kryetarit me vendimet, qëndrimet, kërkesat tona dhe të gjitha këto që i kemi diskutuar sot.

Pika e tetë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre.

Kimeta Shok: - nuk kam se çfarë të them, çdo gjë në rregull.

Nenad Miladinoviç: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se nuk kisha dashur të përsëriten deponitë ilegale, qentë endacakë. Ai në vazhdim ceku shqetësimin, siç tha se para 10 dite në Bërnicën e Poshtme, janë vjedhur 6 shtëpi, për 3 është kupuar menjëherë dhe për 3 shtëpi të tjera më vonë është kupuar se çfarë ka ndodhur. Ekipet kanë dalë në terren edhe forenzika ka qenë e ka kryer punën e saj dhe kjo është e tëra për punën që e di nuk është marrë ndonjë shumë e parave apo materialeve me vlerë deri më tash kaq dimë, kështu që po e presim edhe një raport të policisë, kurse në dy vitet e fundit nuk kemi pasur diçka të ngashme, por vetëm për një natë të thyhen 6 shtëpi ka qenë shqetësuese. Tutje tha se mendimi im është që policia në kohën e fundit më dobët po paraqitet në terren dhe këtë problem e kam paraqitur edhe në vendet tjera, ndërkaq presim që ky bashkëpunim me policinë të rregullohet që të përmirësohet dhe të jenë më shumë në terren në Bërnicë. Probleme të tjera nuk kemi, marrëdhëniet ndëretnike janë të mira, mirëpo kur të janë hajnitë në pyetje hajni është hajn dhe nuk ka lidhje këtu me komunitetin të cilit i takon. Policia kanë qenë KFOR-i të gjithë janë të njoftuar.

Mirsada Behluli: - shtroi pyetje për z. Nenad se a është rregulluar linja e autobusit?

Nenad Miladinoviç: - duke iu përgjigjur znj. Behluli tha se linja e autobusit është lëshuar dhe është funksionale.

Mirsada Behluli: - shtroi pyetje për z. Adnan se a është në rregull, Adnan urdhëro, a është rregulluar ai problemi me ujë.

Adnan Ajeti: - tha se jo nuk është rregulluar.

Betim Abdullahu: - jo kjo shkon me ujësjellës, unë po provoj të kontaktoj dikon nga ujësjellës që ta bëjë si kërkesë a ka lidhje me ujë apo kanalizim.

Nenad Miladoniviç: - duke u ndërlidhur në diskutim tha se unë kur kam këso probleme, i drejtohem Drejtorisë të Shërbimeve Publike, është zoti Habib kolegu jonë ai menjëherë intervenon në ujësjellës dhe rregullohet problemi.

Betim Abdullahu: - tash janë ndarë se Habibi me ekipin kanë dalë në Drejtorinë e Emergjencave.

Mirsada Behluli: - Adnan shikoje me Betimin dhe Betimi të ndihmon për të rregulluar këtë problem. Oktay urdhëro a keni diçka për të thënë.

Oktay Kurtesh: - tha se kemi telashe me qentë endacakë, përvèç qenve endacakë nuk kemi diçka tjetër. Aq sa ka rrezik sa nuk mundemi as me dal jashtë po duhet me veturë me hy në shtëpi brenda. Unë jetoj këtu menjëherë nën Sahat Kullë dhe prej këtu deri në Toukbahqe bëhen 500 qenë brenda natës dhe ndahan, ai qen që vjen nga lart poshtë qëndron në një vend edhe ky poshtë që është nuk shkon lart, kështu që shumë është rrezik, kurse tjera probleme nuk kemi.

Mirsada Behluli: - sa i përket çështjes së sigurisë tha se nuk kemi probleme, nuk është paraqitur ndonjë problem. Mirëpo më duhet të përcjell shqetësimin e komunitetit boshnjak lidhur me koordinatorin për gjuhën boshnjake në Drejtorinë e Arsimit, ku dhe jam marrë shumë me anëtarët e komunitetit, si dhe kam marrë informatë se ligji është në ndryshim dhe nuk i takon. Çdo gjë rregullohet sipas ligjit dhe zonja Jasmina ka qenë aty, konkursi nuk është hapur asnjëherë më dhe ka ardhur ndryshimi në ligj. Herën e kaluar ka qenë zotëria nga Drejtoria për Arsimit z. Lulzim, d.m.th. është drejtori, psikologu, organet tjera të shkollës dhe nuk ka nevojë për një koordinator, komuniteti në mes vete mund ta zgjedhim në mënyrë interne një koordinator i cili na përfaqëson për drejtori dhe organe tjera të shkollës. Në të ardhmen a do të vijë ndonjë ndryshim do ta shohim, unë e kam paraqitur një kërkesë me shkrim drejtorisë, d.m.th. nënkyrjetarës Sahatçiu, që tash është drejtoreshë për arsim, nuk kam marrë ndonjë përgjigje, mirëpo zoti Lulzim në një takim është përgjigjur në mënyrë verbale për këtë situatë.

Procesmbatësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

